



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 30.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr. 06-20304-13/2 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt:13.03.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vazhdimin e pagesës së qirasë edhe për 6 muaj , sipas kontratave për banim për personat e riadhesuar dhe të kthyerit nga Mali i Zi , pas shqyrtimit të kërkesës së z. Naim Cigani nga Gjakova për pagesën qirasë për një periudhë 6 mujore, me dt: 30.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e ZKKK e cila është e ndërlidhur me kërkesën e z. Naim Cigani nga Gjakova nr.16-400-22124 e dt:20.03.2015, për mbulimin e shpenzimeve të pagesës së qirasë së banesës për 6 muaj, për strehimin e familjes së z. Naim Cigani, duke e mbështetur me mjete të subvencioneve të ZKKK në vlerën prej 100€ në muaj, përkatësisht në vlerën totale prej 600€, për 6 muaj .

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerën totale prej 600€ për 6 muaj, për mbulimin e shpenzimeve të qirasë në emër të shfrytëzimit të banesës nga z. Naim Cigani, e cila është në pronësi të z. Selajdin Juniku.

III. Vlera e mjeteve financiare për pagesën e qirasë për 6 muaj do të bartet në mënyrë suksesive në xhirollogarinë e z. Selajdin Juniku nga Gjakova nr. 1704003028397488, NLB Prishtina, sipas kontratës së lidhur me dt:20.03.2015 për dhënien me qira të banesës për 6 muaj, të cilën e shfrytëzon z. Naim Cigani .

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

V. Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Naim Cigani rr. "M. Zajmi", Gjakovë
- Z. Selajdin Juniku rr "M.Zajmi" , Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila